Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	**15.08.2023**	**26.08.2023**	**2023/0573**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.08.2023, **OE "ALFA.i"-** Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0573, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE " INFRAPLUS " SH.P.K."-** Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rregullimi i rrjetit te ujësjellësit ne komunën e Fushe Kosovës ne lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatine e Madhe"** me nr. të prokurimit: **"212-23-2115-5-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal MAPL.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **3,000.000.00 €.**

Fazat e procedurës se prokurimit:

Njoftimi për kontratë.....24.03.2023;

Procesverbali i hapjes së ofertave.....06.06.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së (i fundit).....25.07.2023;

Kërkesa për rishqyrtim 31.07.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....02.08.2023;

Ankesa ne OSHP.....14.08.2023;

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

Njoftimi për Kontratë është bërë me dt. 23.05.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 05.06.2023, ku kanë qenë 4 ofertues. Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me

dt.25.07.2023 ku është rekomanduar për kontratë OE Infra-Plus SH.P.K me çmim prej 2,769.873.91€.

Ndërsa neve jemi eliminuar me arsyetimet si në vijim:

Ju si operatoreve ekonomik në ofertën tuja të dorëzuar në MALP përmes platformës elektronike për projektin në fjalë nuk i keni ofruar dëshmitë e kompletuar për kërkesën e dytë. Ju keni ofruar Z. IDRIZ SHALA për të cilin nuk keni ofruar dëshmi se i ka 5 vite përvojë pune me Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare.

Kërkesa - 3 Operatori ekonomik nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në FDT sepse tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar një Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë; inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezisë, kurse Ju nuk e keni plotësuar këtë kriter sepse keni ofruar dëshmi për barchelor të gjeodezisë nga Universiteti i Prishtinës për z. Fisnik Loshi, si dhe keni ofruar një dokument/diplomë të masterit të për z. Fisnik Loshi ku keni ofruar një dokument nga KTH – Teknologie masterexamen – Degree os Master os Science (120 credits) nga Kungliga Tekniska högskolan – Swiden, ku shkruan se z. Fisnik Loshi ka marr titullin si master i Teknologjisë, që në Suedisht titullohet: "Teknologie masterexamen" ndërsa kur përkthehet në gjuhe shqipe rezulton se ky titull është "Inxhinier i teknologjisë", kurse në gjuhen angleze shkruan "Degree of Master of Sience". Po ashtu edhe në nostrifikimin e diplomës së masterit të këtij personi të dt.27.09.2023 me nr. 6/4-1641, të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nuk shkruan askund se ka fituar gradën Master i Gjeodezisë por shkruan se është vetëm Master i Shkencës studime dy vjeçare dhe asasi nuk ceket apo dëshmohet ne diplome/vendim qe i njëjti është inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë ose Master i shkencave të Gjeodezisë. Prandaj, ne baze të këtyre dëshmive z. Fisnik Loshi nuk e përmbushë kërkesën e AK-se për "Një (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë; inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezise".

Ju si Operator Ekonomik keni dorëzuar Listën e Kontratave të nënshkruar dhe të vulosur mirëpo lista e kontratave dhe Referencave/raporteve nuk e përmbushin kërkesën sipas DT –së sepse ka referenca/raporte të cilat janë lëshuar nga AK tjerë por janë si kontrata të pa përfunduara, gjithashtu në listë OE ka prezantuar kontrata të cilat nuk kanë të bëjnë me natyrën sipas kërkesës ne DT-së referojuni kërkese dhe dëshmisë së 9. Po i cekim kontratat për të cilat ka referanca të lëshuara për kontrata të pa përfunduara si:

Titulli i projektit: "Dranazhimi, kanalizimi, ujësjellësi në Filologjik, FSHNM Filozofik" me numër të prokurimit: 242 -20-3990-5-1-1 për përfundimin e dy situacioneve të lëshuar në vlerë prej 905.000.00 € dhe "Rehabilitimi dhe mirëmbajtja kanalizimit & ujësjellësit" me numër të prokurimit: 622-19-4853-211 është e lëshuar vetëm për realizimin e punimeve deri me datën:11.07.2022 në vlerë prej 603,626.26 €, ndërsa në listë është paraqitur në vlerë prej 1,084,375.00 dhe kjo kontratë është e pa përfunduar. Andaj, ne baze te listës te cilën ju e keni dorëzuar dhe referencave/raporteve, nuk e arrini vlerën e kontratave te realizuara ne vlere prej 4,000,000.00 euro gjate 3 viteve te fundit nga publikimi i njoftimit për kontrate.

Në lidhje me arsyen e parë të eliminimit, ju sqarojmë se në nenin 9.1&9.2 të FDT-së tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale - kërkesa 2 janë kërkuar si në vijim:

Kërkesa 2.

- Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike, me përvoje minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme.

Udhëheqësit e punimeve patjetër duhet të jenë INXHINIER TË DIPLOMUAR, APO MASTER TË HIDROTEKNIKËS. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

Evidenca 2.

-Një kopje të noterizuar të diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-udhëheqësi i punimeve, përmes së cilës inxhinieri deklarohet

-Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; dhe -Minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve te ngjashme
-Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare.

Në lidhje me këtë kërkesë ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme për të plotësuar këtë kërkesë.
Për të dy udhëheqësit e punishtes z. Veton Jahaj dhe Idriz Shala, si dhe për dy gjeodetët z. Valon Bislimi dhe z. Ferid Ahmeti, ne e kemi dëshmuar përvojën e tyre përmes CV-së dhe Referencave, ndërsa i kemi sqaruar AK-së, se ne nuk mund të dorëzojmë kontrata për Inxhinierët të cilët kanë të nënshkruar kontrata me kompanitë e tjera pasi që tek ne nuk janë punëtorë të rregullt. Në lidhje me këta punëtorë na janë kërkuar sqarime shtesë dhe ne kemi dhënë përgjigjet me kohë, ku ndër të tjera kemi sqaruar se kontratat e inxhinierëve dhe të gjeodetëve me kompani të tjera janë konfidenciale, mirëpo në të njëjtën kohë i kemi thënë AK-së se mund ti drejtohen vetë inxhinierëve për këto dëshmi.
Megjithatë pas konsultimeve me inxhinierët përkatës të cilat na kanë lejuar që të prezantohen kontratat e tyre, ne këto kontrata i kemi bashkangjitur me kërkesë për rishqyrtim edhe pse realisht nuk ka qenë obligative dhe e nevojshme sepse përvoja e tyre është dëshmuar me CV dhe referenca.

Në lidhje me arsyen e dytë të eliminimit, ju sqarojmë se tek neni 9.1&9.2 i FDT-së në dosje të tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale është kërkuar:

Kërkesa 3.

- Nje (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë; inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezise me përvojë minimale prej tri (3) vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës).

- Dy (2) inxhinier bachelor i gjeodezisë, me përvojë minimale prej 3 vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës).

Evidenca 3.
Një kopje të noterizuar të diplomës dhe licencës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të inxhinierit të gjeodezisë (deklaratë, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se është i angazhuar në këtë projekt-kontratë;
- Një kopje të CV-së e nënshkruar nga vet ing.;
- Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.
-Minimum tri referenca për projekte te ngjashme
-Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 3 vjeçare.
- Certifikata qe është i licencuar nga AKK

Sa i përket gjeodetit të prezantuar nga ne, z. Fisnik Loshi, ju sqarojmë se i njëjti ka diplomën e bachelorit në gjeodezi, ndërsa masterin e ka të përfunduar në Suedi dhe diploma e tij në Suedi është në dy gjuhë (suedeze dhe angleze). Në diplomë shkruan mjaft qartë se z. Loshi është master i shkencave, programi menaxhim i tokave (Land Management) e jo Master i teknologjisë siç pretendon AK-ja, prandaj kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme.

Për më tepër inxhinieri në fjalë ka Licencën e gjeodetit dhe atë të vlefshme nga 05.10.2018

shumë vite se sa kërkesa e dosjes së tenderit (prej tri vite). Ky gjedoet është i regjistruar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Ne kemi kërkuar sqarime nga universiteti ku i ka kryer studimet z. Fisnik loshi dhe nga ky universitet është sqaruar se titulli Tekonologie masterexamen në gjuhen angleze përkthehet si Master of Science, e që në shqip përkthehet Master i Shkencave.

Ky fakt vërehet edhe ne sylabusin e bashkangjitur nga fakultetit ku shkruan: Students who have successfully completed the programme will be awarded a "Teknologie masterexamen", translated into English as "Degree of Master of Science (two years)".

Duke pasur parasysh këtë sqarim rezulton se ky arsyetim i AK është i pabazë sepse Diploma e z.Loshi është e përkthyer edhe ne gjuhen angleze e në të cilën qartë ceket se është Master i shkencave - drejtimi Menaxhim i tokave.

Bashkangjitur keni programin e studimeve dhe dëshmitë e tjera.

Prandaj, në universitet tjera nuk do të thotë se titulli të merret sikurse në Universitet të Prishtinës-vetëm gjeodet por me rëndësi është të përputhet programi i studimeve.

Siç kemi sqaruar z.Loshi është edhe profesor ne fakultetin e UP, e ku mund të vërtetohen fare lehte lëndët të cilat i ligjëron, ndërsa po të ishte inxhinier i Teknologjisë z. Fisnik Loshi siç pretendon AK-së, ai nuk do të mund të ligjëronte në fushën e Gjeodezisë.

Në lidhje me **arsyen e tretë** të eliminimit, ju sqarojmë se në nenin 9.1&9.2 të DT-së tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kërkesa 9 janë kërkuar si:

Kërkesa 9.

- Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës,

Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjashme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë te jete min 4,000,000.00 Euro. -OE te ketë se paku 1,000,000.00 euro , mund të mbulohet me disa Referenca për punë të njëjta (Punime të rrjetave të Ujësjellësit).

Shënim: Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.

Dëshmia 9.

Lista e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, Listës së kontratave duhet ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë.

Në lidhje me këtë kërkesë, ne kemi dorëzuar kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë prej 6.3 milion euro, prandaj kemi plotësuar kërkesën e lartcekur në FDT, e po ashtu kemi plotësuar kriterin për kontrata në ujësjellës prej minimum 1milion Euro.
Edhe nëse AK-ia nuk i ka pranuar dy referencat tjera atë të UP dhe KK Prizren (edhe pse

MMPH_Ujesjellesi ne Kacanik- 1,235,638.36 Euro
KK Podujeve_Sheshi ne Podujeve (ujesjelles, kanalizim, rruge) - 2,269,821.95 Euro
KUR Prishtina_Ujesjellesi ne Lipjan, Podujeve - 170,162.65 Euro
CDI_Rehabilitimi i pusetave - 108,985.28 Euro
CDI_Ujesjellesi ne Malisheve - 253,945.97 Euro
KK Kacanik_Ujesjellesi ne Kacanik - 46,396.25 Euro
KK Istog_Ujesjellesi ne Banje - 117,300.50 Euro
KK Istog_Ndertimi i skemes per furnizim me uje - Rrjeti Sekondar - 246,704.07 Eu

Vlera Totale e vetëm këtyre referencave është: **4,448,955.03 Euro**, pra mbi vlerën e k
së AK.

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.02.08.2 autoriteti kontraktues nuk ka dhënë ndonjë arsye konkrete se përse është r kërkesa për rishqyrtim.

Në lidhje me pretendimin e parë ankimor, autoriteti kontraktues është përgjigjur s kërkesë për sqarime kemi refuzuar të dorëzojmë kontratat e dy inxhinierëve me ars se janë konfidenciale, ndërsa tani me kërkesë për rishqyrtim janë dorëzuar por dorëzuar jashtë afatit dhe kjo bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.
Ky arsyetim i AK-së është i pa qëndrueshëm, sepse fillimisht kontrata nuk ka obligative për të dështuar përvojën e punës, pasi që përvoja është dështuar me re dhe CV, ndërsa në kohën e sqarimeve inxhinierët kanë hezituar të na ofrojnë k mirëpo më pastaj pas insistimeve tona kanë pranuar të na dështojnë kontratat dhe n bashkangjitur me kërkesë për rishqyrtim.
Duke pasur parasysh se përvoja ka qenë e dështuar me referenca dhe CV atëherë d ose jo i këtyre kontratave nuk ka pas ndonjë relevancë, prandaj edhe dorëzimi me për rishqyrtim nuk përbën ndonjë favorizim për kompaninë tonë për faktin së kanë dështuara përvojat e të dy inxhinierëve. Thjesht kontratat nuk kanë ndonjë rëndësi a në këtë rast dhe nuk krijojnë ndonjë përparësi apo avantazh.

Në lidhje me pretendimin e dytë ankimor AK-ja e ka cekur ekziston një vendim i së me Nr.88/20 i dt.03.03.2020 ku është hedhur poshtë një pretendim i tillë, e po as cekur se arsyetimi se është ligjërues z. Fisnik Loshi nuk ka të bëjë me kërkesën e d tenderit.
Sa i përket këtij vendimi të OSHP-së, ju sqarojmë se në faqen **nr.7 të vendim "Paneli shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit konfor 72 të LPP-së duhet të kërkojë sqarime shtesë dhe të sigurohet se grupi i oper ekonomik të rekomanduar për kontratë ka ofertuar/tenderuar sipas kërke**

Pra vendimi i panelit shqyrtues e ka konsideruar devijim të vogël këtë çështje dhe ky
është nxjerr nga paneli i njëjtë, që kishte nxjerr vendimin paraprak të cilit i referohe

Pra ka edhe vendime të panelit shqyrtues që diploma e z.Fisnik Loshi është marr p
si valide, mirëpo AK-ja i është referuar një vendimi paraprak ku është cekur se
kërkohen sqarime shtesë e nuk e ka pas informatën apo qëllimisht nuk e ka cekur s
vendim për lëndën e njëjtë e ku është marr valide diploma e z. Fisnik Loshi.

Vendimi **88/20** që i është referuar AK-ja dhe vendimi që po i referohem ne **Nr.203**
për të njëjtin aktivitet të prokurimit me titull "Mirëmbajtja e objekteve të admi
komunale në Prizren" me nr. prok:622-19-9123-2-1-1, inicuar nga AK-së KK Prizre
Çështja për inxhinierin e njëjtë ishte e trajtuar edhe në urdhëresën e dt.281
ekspertizën e njëjtë.

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor, AK-së nuk ka dhënë ndonjë arsyetim për
mirëpo vetëm e ka përshkruar arsyen e eliminimit, prandaj janë të paqëndrueshm
arsye sepse ne kemi ofruar dëshmi që tregojnë se kemi vlerë më të madhe kontrata
kërkesa e dosjes së tenderit, e po ashtu këto kontrata janë të natyrës së kërkuar.

Duke pasur parasysh të gjitha sqarimet që u cekën më lartë, kuptohet qartë se ne
plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prand
dashur të shpallemi të përgjegjshëm dhe të rekomandohemi për kontratë.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë konstato
ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nen
LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që l
tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 p
1.1 i LPP-se, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Çmimi që ne kemi ofertuar është 2,538,518.34 €, kurse OE i rekomanduar për kontra
në vlerë prej 2,769.873.91€, e që rezulton se diferenca e ofertimit është n
prej:**231,355.57 €**, e që është diferencë shumë e madhe.

Me këtë diferencë mund të përfundohet edhe një projekt shumë i rëndësishëm për q
prandaj duhet pasur parasysh këtë fakt shumë me rëndësi.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve d

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojr OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **ALFA i**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të l dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instanc më të larta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**1. Qarkulli financiar nga një bankë e licencuar në vlerë prej 4,500 000.00 € në 3 (tri) vitet e fundit para datës së Njoftimit për Kontratë.**	**1. Raporti financiar nga një ose më shumë Banka.**
Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kërkesa 1.** **Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara në ofertën e tij, duhet të vërtetoj se në resurset e veta njerëzore ka stafin si në vijim. - Një (1) menaxher të projektit inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike me përvojë minimale prej 10 vite pas diplomimit dhe në menaxhimin e projekteve të ngjashme.**	**Evidenca 1.** **- Një kopje të noterizuar të diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-menaxheri i projektit, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se do jetë i angazhuar në këtë projekt-kontratë;** **-Një kopje te CV-së e nënshkruar nga vet ing.** **-Një kopje të kontratës ose para kontratës valide te punës; -Minimum tri referenca për menaxhimin e projekteve te ngjashme -Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 10 vjeçare.**
		Kerkesa 2. **- Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar**	**Evidenca 2.** **-Një kopje të noterizuar të diplomës diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe**

		të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike , me përvoje minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme.Udhëheqësit e punimeve patjetër duhet të jenë INXHINIER TË DIPLOMUAR, APO MASTER TË HIDROTEKNIKËS.	**një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-udhëheqësi i punimeve, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se do jetë i angazhuar në këtë projekt-kontratë;** **-Një kopje të CV-së e nënshkruara nga vet ing.;** **-Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; dhe -Minimum një referencë si mbikqyres i projekteve te ngjashme -Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare.**
		Kerkesa 3. **- Nje (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë;** **inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezise me përvojë minimale prej tri (3) vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës). - Dy (2) inxhinier bachelor i gjeodezisë, me përvojë minimale prej 3 vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës)**	**Evidenca 3.** **Një kopje të noterizuar të diplomës dhe licencës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të inxhinierit të gjeodezisë (deklaratë, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se është i angazhuar në këtë projekt-kontratë;** **- Një kopje të CV-së e nënshkruar nga vet ing.;** **- Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.** **-Minimum tri referenca për projekte te ngjashme** **-Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 3 vjeçare. - Certifikata qe është i licencuar nga AKK**
		Kërkesa 4.-Tre (3) Saldues për gyp HDPE, të çertifikuar sipas EN-13067.	**Evidenca 4.** **Kopja e noterizuar e çertifikatës së trajnimit e lëshuar nga një institucioni i autorizuar për trajnime të tilla. Një kopje të kontratës valide të punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.**

		Kërkesa 5. **Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara në ofertën tenderin e tij, duhet të vërtetoj se posedon pajisjet si vijon** **- 2 (dy) Eskavator minimum 20 ton** **- 2 (dy) Eskavator 9-18 ton** **- 2 (dy) Mini Eskavator nën 5 ton** **- 1 (nje) Luge ngarkuese, kapaciteti i luges 1m3** **- 6 (gjashtë) Kamion minimum 12 ton pesha bartese** **- 3 (tre) Kamion min 3-4 ton** nënkupton peshën bartëse të kamionit. **- 1 (një) prerëse e Asfaltit,** **- 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me system laserik ose** makinë shpuese pa llaser të kontrollit deri në diametrin 500 mm **- 3 (tri) makina për saldim ballor** **- 3 (tri) makina për saldim elektrofuziv** **- 1 (një) Cilinder ngjeshës 4-5 ton** **- 2 (dy) Damper 2-4 ton** **- 3 (tri) makina ngjeshëse (papuqe) te dheut.** **- Rrethoja për sigurim te punishtes min 100m - Mbrojtëse kanali metalike min 25m`**	**Dëshmia 5.** **Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E.** **Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit me validitet ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj.).** **Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.** **Vërejtje:** **Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet. Fotot për Rrethojën, mbajtëset metalike të kanalit, kompresorit dhe semaforëve sinjalizues**

		- 1 (një) Kompresor - Semafora sinjazilues mobil .	
		Kërkesa 6. OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar"	**Dëshmia 6. Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet (pozicionet) që janë të përfshira në paramana.**
		Kërkesa 7. OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, Planin e detajuar për Menaxhimin e trafikut.	**Dëshmia 7. Përshkrimi i planit për menaxhimin e trafikut i hartuar dhe i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit.**
		Kërkesa 8. Një (1) teknik të ndërtimtarisë ose komunikacionit mund të mbulohet me persona te kualifikuar si "Inxhinier i Ndërtimtarisë" apo "Inxhinier i Komunikacionit" **me përvoje minimale prej 2 vite.**	**Dëshmia 8.** **Një kopje të noterizuar të diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj) dhe një deklaratë ose para kontratë përmes së cilës deklarohet se është i angazhuar në këtë projekt-kontratë; -Një kopje të kontratës valide të punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.** **- Minimum një referencë për projekte te ngjashme -Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën dy (2) vjeçare.**
		Kërkesa 9. **- Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës,** **Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjajshme** si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë **te jete**	**Dëshmia 9. Lista e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, Listës së kontratave duhet ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë.**

		min 4,000,000.00 Euro. **- OE te ketë se paku 1,000,000.00 euro** , mund të mbulohet me disa Referenca për punë të njëjta (Punime të rrjetave të Ujësjellësit). **Shënim Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.**	
		Kërkesa 10. **Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. – Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 20 punonjës, min 2 prej tyre te jene te certifikuar për Siguri dhe Shëndet ne pune.**	**Dëshmia** **10. Lista e punëtoreve me kontrata ose me Liste të ATK-së.** **Për dy punonjës me certifikatë te sigurisë mund të kenë edhe një kopje te kontratës; para kontratës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Dokumenti	Grup i Operatorëve Ekonomik ILEAA - GR SH.P.K.; UNION RAKETA SHPK Dega në Kosovë	" Infra-Plus " SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik K-ING SH.P.K.; HIDRO PROJECT SH.P.K.; Urban O.P.	ALFA.i - "Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe"
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
Kërkesa 1. Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara në ofertën e tij, duhet të vërtetoj se në resurset e veta njerëzore ka stafin si në vijim. - Një (1) menaxher të projektit inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike me përvojë minimale prej 10 vite pas diplomimit dhe në menaxhimin e projekteve të ngjashme.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kerkesa 2. - Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike , me përvoje minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme;	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm
Kerkesa 3. - Nje (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë; inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezise me përvojë minimale prej tri (3) vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës). - Dy (2) inxhinier bachelor i gjeodezisë, me përvojë minimale prej 3 vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës)	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm
Kërkesa 4.-Tre (3) Saldues për gyp HDPE, të çertifikuar sipas EN-13067.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kerkesa 5. Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara në ofertën tenderin e tij, duhet të vërtetoj se posedon pajisjet si vijon - 2 (dy) Eskavator minimum 20 ton - 2 (dy) Eskavator 9-18 ton - 2 (dy) Mini Eskavator nën 5 ton - 1 (nje) Luge ngarkuese, kapaciteti i luges 1m3 - 6 (gjashtë) Kamion minimum 12 ton pesha bartese - 3 (tre) Kamion min 3-4 ton - 1 (një) prerëse e Asfaltit, - 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me system laserik,ose makinë shpuese pa llaser të kontrollit deri në diametrin 500 mm . - 3 (tri) makina për saldim ballor - 3 (tri) makina për saldim elektrofuziv - 1 (nje) Cilinder ngjeshes 4-5 ton - 2 (dy) Damper 2-4 ton - 3 (tri) makina ngjeshëse (papuqe) te dheut. - Rrethoja per sigurim te punishtes min 100m - Mbrojtese kanali metalike min 25m` - 1 (një) Kompresor - Semafora sinjazilues mobil .	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	Në pajtim
Kerkesa 6. OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar"	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kerkesa 7. OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, Planin e detajuar per Menaxhimin e trafikut.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kerkesa 8. Një (1) teknik të ndërtimtarisë ose komunikacionit , me përvoje minimale prej 2 vite.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kerkesa 9. - Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës, Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjajshme te jete min 4,000,000.00 Euro . - OE te kete se paku 1,000,000.00 euro referenceca per ndertim te ujesjellesit . Shënim Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm
Kërkesa 10. Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. – Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 20 punonjës, min 2 prej tyre te jene te certifikuar për Siguri dhe Shëndet ne pune.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

1. ALFA.i rr. Ibrahim Rugova pn., Lipjan 810298853

Kërkesa - 2 Për IDRIZ SHALA Mungonte kontrata e punës e cila dëshmon përvojën e punës 5 vjetarë sipas krekës së FDT –së, ne si AK dhe komision i vlerësimit në bazë të Rregullore Nr. 001 /2022 Për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në Neni 38 Sqarimi i Tenderëve me datën: 18.07.2023 kemi kërkuar sqarime përmes B47 Letrës Standarde Kërkesës për Sqarime e Tenderit dhe Ju si OE ALFA I jeni përgjigjur brenda afateve të përcaktuara, por në dokumentacioni e ofruar prapë nuk i keni sjellur/bashkangjitur dëshminë e kërkuar sipas DT-së,
Kërkesa -2 Për VETON JAHAJ Mungonte kontrata e punës e cila dëshmon përvojën e punës 5 vjetarë sipas krekës së FDT –së, ne si AK dhe komision i vlerësimit në bazë të Rregullore Nr. 001 /2022 Për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në Neni 38 Sqarimi i Tenderëve me datën: 18.07.2023 kemi kërkuar sqarime përmes B47 Letrës Standarde Kërkesës për Sqarime e Tenderit dhe Ju si OE ALFA I jeni përgjigjur brenda afateve të përcaktuara, por në dokumentacioni e ofruar prapë nuk i keni sjellur/bashkangjitur dëshminë e kërkuar sipas DT-së,

Kërkesa - 3 Operatori ekonomik nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në FDT sepse tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose master) kurse OE Alfa I nuk e ka plotësuar këtë kriter sepse ka ofruar dëshmi për barcelor të gjeodezisë nga Universiteti i Prishtinës për z. Fisnik Loshi, ndërsa ka ofruar një dokument/diplomë të masterit të këtij personi, ku shkruan se z. Fisnik Loshi ka marr titullin si master i Teknologjisë që në Suedisht titullohet: Teknologie masterexamen, ndërsa kur përkthehet në gjuhe shqipe rezulton se ky titull është Inxhinier i teknologjisë, kruese në diplomë në gjuhen angleze shkruan Degree of Master of Sience. Po ashtu edhe në nostrifikimin e diplomës së masterit të këtij personi të dt.27.09.2023 me nr. 6/4-1641 të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nuk shkruan se ky person ka fituar gradën Master i Gjeodezisë por shkruan se është vetëm Master i Shkencës studime dy vjeçare dhe nuk shkruan se kjo diplomë përputhet me ndonjë program të gjeodezisë të Universitetit të Prishtinës, prandaj me këto dëshmi kuptohet që nuk është përmbush kërkesa e AK –së në lidhje me Nje (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë; inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezisë.
Kërkesa 9. Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës, Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjajshme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë te jete min 4,000,000.00 Euro. OE te ketë se paku 1,000,000.00 euro , mund të mbulohet me disa Referenca për punë të njëjta (Punime të rrjetave të Ujësjellësit). Shënim, Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.
Dëshmia 9. Lista e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, Listës së kontratave duhet ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë.

Ndërsa Operatori Ekonomik ka dorëzuar Listën e Kontratave të nënshkruar dhe të vulosur mirë po lista e kontratave dhe Referencave/raporteve nuk janë në harmoni nuk e përmbushin kerkesen sepse ka referenca/raporte të cilat janë lëshuar nga AK tjerë por janë si kontrata të pa përfunduara gjithë ashtu në listë OE ka prezantuar kontrata të cilat nuk kanë të bëjnë me kërkesën sipas DT-së referojuni kërkese dhe dëshmisë së 9. Po i cekim kontratat për të cilat ka referanca pjesërisht të lëshuara kontrata të pa përfunduara si:
Titulli i projektit: "Dranazhimi, kanalizimi, ujësjellësi në Filologjik, FSHNM Filozofik" me numër të prokurimit: 242 -20-3990-5-1-1 për përfundimin e dy situacioneve të lëshuar në vlerë prej 905.000.00 € dhe "Rehabilitimi dhe mirëmbajtja kanalizimit & ujësjellësit" me numër të prokurimit: 622-19-4853-211 është e lëshuar vetëm për realizimin e punimeve deri me datën:11.07.2022 në vlerë prej 603,626.26 € ndërsa në listë është paraqitur në vlerë prej 1,084,375.00 dhe kjo kontratë është e pa përfunduar. Duke i parë këto të cilat i kemi cekur më lartë OE nuk e përmbushë këtë kërkesë.

2. Grup i Operatorëve Ekonomik ILEAA - GR SH.P.K.; UNION RAKETA SHPK Dega në Kosovë Rr. Mehmet Gradica Hyrja 6/2, Prishtinë

AK dhe komision i vlerësimit në bazë të Rregullore Nr. 001 /2022 Për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në Neni 38 Sqarimi i Tenderëve me datën: 18.07.2023 kemi kërkuar sqarime përmes B47 Letrës Standarde Kërkesës për Sqarime e Tenderit ndërsa OE ILEAA - GR SH.P.K.; UNION RAKETA SHPK nuk i ka ofruar fare dëshmitë e kërkuara sipas krekës, B47 dhe DT-së dhe kjo ofertë është e pa përgjegjshme për arsyeje sime poshtë .

Kërkesa 1 Tek Menaxheri i Projektit Selim Hyseni ka ofruar vetëm një referencë ndërsa është kërkuar minimum 3 referenca sipas FDT –së.

Kërkesa 2 Për AVDI ÇITAKU Mungonte kontrata e punës e cila dëshmon përvojën e punës 5 vjetarë sipas krekës së FDT –së, OE në ofertën e tije ka ofruar dëshmi vetëm për 3 cite përvojë pune.

Kërkesa 5 tek kërkesa në fjalë/dëshmia është kërkuar Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët ndërsa OE 2. Grup i Operatorëve Ekonomik ILEAA - GR SH.P.K.; UNION RAKETA SHPK nuk ka ofruar deshmit konform DT dhe B47 Letrës Standarde Kërkesës për Sqarime e Tenderit ndërsa andaj këtë pik nuk e përmbushë.

3. Grup i Operatorëve Ekonomik K-ING SH.P.K. HIDRO PROJECT SH.P.K.; Urban O.P. Kalabria Blloku A1 Llamella B K5/18, PRISHTINË

Kërkesa 5. Tek kjo kërkesë është kërkuar - 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me system laserik ose makinë shpuese pa llaser të kontrollit deri në diametrin 500 mm nders OE, K-ING SH.P.K. HIDRO PROJECT SH.P.K.; Urban O.P. ka ofruar një makinë e cila nuk është në harmoni me kërkesën e DT-së OE në fjalë ofron një makinë sipas DUD –it doganor nuk i plotëson kërkesat e AK –së Ju keni ofruar makinën për shpim horizontal me pjesë përcjellëse marka Dith Witch Jet Track Tip: 2720 e cila nuk është sipas kerkese së AK –së.

Kërkesa 9. Sipas kërkese së AK –së në DT është kërkuar si kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës, Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjajshme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë te jete min 4,000,000.00. Shënim, Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë. OE te ketë se paku 1,000,000.00 euro , mund të mbulohet me disa Referenca për punë të njëjta (Punime të rrjetave të Ujësjellësit).
Shënim
Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.

Sipas listës të cilën e ka dorëzuar OE tek projekti me titull: Ndërtimi i një sistemi të furnizimit pijshëm për fshatrat e Rekës së Keqe dhe Luginës së Carragojës Komuna e Gjakovës në financuar nga Community Development Initiaties – CDI vlera e së cilës është: 500,199.75 € dhe data e kompletimit të projektit është: 25.02.2020 si dhe keni ofruar një Raport i cili i ka pranuar punët me datën: 25.02.2020, dhe i cili nuk është në harmoni me kërkesat tona dhe është projekt jashtë periudhës të caktuar 3 vjeçare, dhe Ju si lider i grupit K-ING SH.P.K. nuk e përmbushni/mbuloni 60% të referencave të kërkuara më lartë sipas DT-së.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Sqarimet shtese permes pergjigjeve ne emailin e dates 23.08.2023 dhe 28.08.2023

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ALFA.i**

Përgjigje në Pretendimin Nr.1:

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me pretendimin e pare kërkesa e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë është:

Kërkesa 2.

- **Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike , me përvoje minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme.**

Udhëheqësit e punimeve patjetër duhet të jenë INXHINIER TË DIPLOMUAR, APO MASTER TË HIDROTEKNIKËS.

Ndërsa dëshmi e dokumentuar është kërkuar:

Evidenca 2.

-Një kopje të noterizuar të diplomës diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-udhëheqësi i punimeve, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se do jetë i angazhuar në këtë projekt-kontratë;

-Një kopje të CV-së e nënshkruara nga vet ing.;

-Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; dhe

-Minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve te ngjashme

-Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare.

OE ankues për kërkesën e 2 ka dorëzuar dëshmitë për inxhinieret V.J dhe I.SH. Ne oferte OE ankues nuk ka bashkangjitur "**Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare"** për inxhinieret sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Pretendimi i OE ankues se ***"realisht kontratat nuk kane qenë obligative dhe te nevojshme sepse përvoja është dëshmuar me CV dhe referenca"*** *dhe* ***"kontratat nuk kane ndonjë rëndësi apo vlere "*** nuk qëndron sepse kjo kërkesë është e përcaktuar qarte ne dosjen e tenderit.

Për me tepër OE ankues ne fazën e tenderimit ka pas mundësinë qe ta atakojë kërkesën e mësipërme por nuk e ka bërë një gjë te tillë.

AK-ja ne përputhje nenin 38.1 te RRPP 38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një *formular standard* B47 për sqarime për të përdorur nga AK *"Kërkesë për sqarim të tenderit".* Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike.

kishte kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues në lidhje me dëshmitë që kanë të bëjnë dëshmitë e kontratave të punës për inxhinieret.

OE ankues ka kthyer ka kundërshtuar dhënien e dëshmive me përgjigjen:

Për dy udhëheqësit e punishtës z. Idriz Shala dhe z. Veton Jahaj, ju sqarojmë se dëshmia për përvojen e punës së tyre mbulohet/dëshmohet nga CV-ja dhe referencat e lëshuara të cilat për cdo rast po i përcjellim përsëri dhe me të cilat vërtetohet dhe plotësohet përvoja 5 vjecare sipas kërkesës në DT.
Për shkak se inxhinierët në fjalë nuk janë punëtorë të rregullt të kompanisë sonë por vetëm bashkëpunëtor të jashtëm, nuk bie në kompetencën tonë që të ju përcjellim kontratat pasi ato janë konfidenciale (në mes të kompanisë ku janë punëtor të rregullt dhe inxhinierit) mirëpo nëse ju si AK e shihni të arsyeshme mund ti kontaktoni direkt inxhinierët rreth përvojës së tyre dhe dëshmive shtesë edhe pse ne qëndrojmë mbrapa asaj se është e mjaftueshme dëshmia pëmes CV-së dhe referencave!

Përvoja qe i referohet OE ankues e Inxhinerit I.SH sipas CV nga viti 2011 – 2021 është me OE ankues (ALFA I) (pervec 2014-2015 qe është me INFRATEK) përderisa kontrata e dorëzuar me kërkesë për rishqyrtim për te njëjtin është nga viti 2011 me OE (Infratek).

Eksperti shqyrtues sqaron se ne kërkesën për sqarim te paragrafi i fundit AK-ja ka kërkuar "

"Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues ose në numrin e faks-it *[038 200 64207]* apo në e-mailit *[shkelzen.hoxha@rks-gov.net* brenda dy *[2*] ditëve nga data e kësaj kërkese.

Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet."

OE ankues ka dështuar që ti dorëzojë dëshmitë e kërkuara nga AK-ja sipas kërkesës për sqarim dhe ka vendosur në përputhje me nenin 38 te RRPP 001/2022 paragrafët 38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre.

38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ne këtë pike ankimore ka vepruar ne përputhje me Nenin 38.7 te RRPP 001/2022 dhe nenin 7 **Neni7 BarazianëTrajtim/Jo-Diskriminimi**

Autoriteti kontraktuesdo titrajtojoperatorëtekonomiknë mënyrëtëbarabartëdhejo- diskriminuese dhedo tëveprojë nëmënyrë transparente.

Prandaj pretendimi ankimor për këtë pike **nuk është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin Nr. 2:

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me kërkesën:

Kërkesa 3.

- Nje (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë;

inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezisë me përvojë minimale prej tri (3) vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës).

Evidenca 3.

Një kopje të noterizuar të diplomës dhe licencës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të inxhinierit të gjeodezisë (deklaratë, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se është i angazhuar në këtë projekt-kontratë;

- Një kopje të CV-së e nënshkruar nga vet ing.;

- Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.

-Minimum tri referenca për projekte te ngjashme

-Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 3 vjeçare.

- Certifikata qe është i licencuar nga AKK.

Eksperti shqyrtues sqaron se me ofertë OE ankues ka dorëzuar dëshmi për F.L i cili diplomën Master e ka dorëzuar nga Suedia me titullin "Teknologie masterexamen" dhe me gradën e fituar "Master i shkencave".

OE ankues i referohet programit te studimeve si "Menaxhim i tokave". Ne nostrifikimin e diplomës nga Ministria e Arsimit me nr. 6/4-1641 poashtu vërtetohet se grada e fituar është "Master i Shkencës" duke mos ju referuar programit te studimit.

Sidoqoftë F.L ishte licencuar nga MMPH sipas licencës me numër 76 te datës 05.10.2023 ku i njëjti licencohet si Gjeodet prandaj bazuar ne dëshmitë dhe provat e prezantuara eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor ne këtë pikë **është pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin Nr. 3:

Lidhur me pretendimin e tretë qe ka te bëjë me

Kërkesa 9.

- Kontrata të natyrës së punëve **të ndërtimit të ujësjellësve**, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës,

Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjashme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat **për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë** te jete min. 4,000,000.00 Euro.

Dëshmia 9.

Lista e Kontratave të **natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve**, Listës së kontratave duhet ti **bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë**.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues me ofertën e tij ka dorëzuar listën e kontratave për te cilat ka bashkangjitur referenca apo pranime teknike.

Gjate fazës se kërkesës për rishqyrtim OE ankues ka pretenduar se ne listën e kontratave te dorëzuara janë kontratat te cilat pretendon se i plotësojnë kriteret sipas dosjes se tenderit sipas listës me poshtë:

MMPH_Ujesjellesi ne Kacanik- 1,235,638.36 Euro
KK Podujeve_Sheshi ne Podujeve (ujesjelles, kanalizim, rruge) - 2,269,821.95 Euro
KUR Prishtina_Ujesjellesi ne Lipjan, Podujeve - 170,162.65 Euro
CDI_Rehabilitimi i pusetave - 108,985.28 Euro
CDI_Ujesjellesi ne Malisheve - 253,945.97 Euro
KK Kacanik_Ujesjellesi ne Kacanik - 46,396.25 Euro
KK Istog_Ujesjellesi ne Banje - 117,300.50 Euro
KK Istog_Ndertimi i skemes per furnizim me uje - Rrjeti Sekondar - 246,704.07 Euro

AK-ja me vendimin ne kërkesë për rishqyrtim ka vlerësuar se kontratat nuk e përmbushin kriterin sipas dosjes se tenderit ne vlere prej 4,000.000.00.

Eksperti shqyrtues sqaron se me Opinionin e KRPP-se te datës 09.06.2023 11. ***Cili është përkufizimi i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme" në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?***

Është interpretuar se Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në këte rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

AK-ja ne këtë aktivitet te prokurimit ka kërkuar qe dëshmitë te jenë për "**për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë".**

Sa i përket pretendimit qe ka te bëjë me pranimin e kontratave kornizë për punët e kryera çdo vit eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i tille nuk qëndron dhe kjo është sqaruar me interpretimi i KRPP-se i datës 22.11.2022 me nr. 10 qe përkufizon:

10. 22.11.2022 Kurdo që kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Sa i përket dëshmive të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton: 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira,shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja ecertifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; Në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, **AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës.** Për më shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hijezuara në këtë nën-paragraf: Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin. **Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet.**

Eksperti shqyrtues ka kërkuar sqarime nga AK-ja përmes kërkesës për sqarim për listën e kontratave si me larte dhe arsyetimi për emërtimin dhe vlerën e kontratës e/te cilat nuk janë pranuar nga AK-ja dhe kemi marrë përgjigjen.

Shkelzen Hoxha <Shkelzen.Hoxha@rks-gov.net> Mon, Aug 28, 2023 at 1:48 PM
To: burim zekaj <burim.zekaj@gmail.com>
Cc: Zelihe Morina <Zelihe.Morina@rks-gov.net>

I nderuar,

Përgjigjeja është se projekti i dytë nuk është në përputhje kërkesat e dosjes së tenderit për ujësjellës, kanalizim dhe rrugë dhe rrjedhimisht nuk është pranuar, projekti sipas raportit të pranimit është ndërtimi i bulevardit dhe sheshit në Podujevë dhe ska të bëjë me asnjë nga ato që është kërkuar.

Faleminderit për bashkëpunim, ne jemi të hapur për çdo informatë shtesë.

From: burim zekaj [mailto:burim.zekaj@gmail.com]
Sent: Saturday, August 26, 2023 7:32 PM
To: Shkelzen Hoxha <Shkelzen.Hoxha@rks-gov.net>
Subject: Kërkesë për info shtese ankesën OE Alfa I

Të nderuar

Se pari ju falënderoj për përgjigjen e dhëne ne pyetjen qe ka te beje me ankesën e OE Alfa I ne lidhje me Ankesën 2023/573. Qe te beje një vlerësim objektiv me duhet edhe një sqarim shtese qe ka te beje me listën e kontratave te OE ALFA I.

Sipas kërkesës për rishqyrtim OE ALFA I nga lista e kontratave të dorëzuar me oferte ka pretenduar se kontratat si me poshtë te cilat janë pjese e listës e përmbushin kërkesën sipas dosjes se tenderit:

MMPH_Ujesjellesi ne Kacanik- 1,235,638.36 Euro
KK Podujeve_Sheshi ne Podujeve (ujesjelles, kanalizim, rruge) - 2,269,821.95 Euro
KUR Prishtina_Ujesjellesi ne Lipjan, Podujeve - 170,162.65 Euro
CDI_Rehabilitimi i pusetave - 108,985.28 Euro
CDI_Ujesjellesi ne Malisheve - 253,945.97 Euro
KK Kacanik_Ujesjellesi ne Kacanik - 46,396.25 Euro
KK Istog_Ujesjellesi ne Banje - 117,300.50 Euro
KK Istog_Ndertimi i skemes per furnizim me uje - Rrjeti Sekondar - 246,704.07 Euro

Vlera Totale e vetëm këtyre referencave është: **4,448,955.03 Euro,** pra mbi vlerën e kërkesës së AK.

Ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim keni arsyetuar se lista e kontratave me dëshmitë e dorëzuara nuk e plotësojnë kërkesën sipas kërkesave te dosjes se tenderit.

Pyetja është: Cilat kontrata si me lartë nuk e kanë përmbushur kriterin e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Kontrata e prezemtuar nga OE ankues:

Në bazë të kërkesës së Konsorciumit Afa-I dhe Konstruktori Ing 1969 për pranimin teknik të punimeve të kryera në projektin Ndërtimi i bulevardit dhe sheshit (Sheshi i dëshmorëve në qendër të qytetit)"si dhe me vendimin nr 02-020/04-0094973/21 të Kryetarit të Komunës të datës 27.10.2021 ,është formuar Komisioni për pranimin-kontrollimin e punimeve të kryera sipas aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi i bulevardit dhe sheshit (Sheshi i dëshmorëve në qendër të qytetit)", në këtë përbërje:

Eksperti shyrtues vlereson se AK-ja ka vepruar ne përputhje me **Neni59 EkzaminimiVlerësimidheKrahasimiiTenderëve**

4. Autoriteti kontraktues dotëkonsiderojënjëtendersi tëpërgjegjshëmvetëmnësetenderinë fjalëështë nëpërputhshmërimetëgjithakërkesateparashtruaranë njoftimine kontratësdhenë dosjenetenderit.

Prandaj bazuar në deshmite pjesë e dosjës se tenderit, vlerësimin e komisionit, sqarimet shtesë eksperti shqyrtues vlereson se pretendimi ankimor **nukështë i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ALFA.i**

Burim Zeka